



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 29

Prishtinë, më 3.11.2011, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

**PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Daut Haradinaj, Afërdita Berisha-Shaqiri, Etem Arifi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: Anëtarët e këshillit trashëgimor (Zymer Neziri dhe Gjejlane Hoxha, Edi Shukriu nuk ishte prezente-me arsyetim), zyrtar, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës ,**
2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 31.10.2011,**
3. **Takimi me Këshillin e Trashëgimisë Kulturore,**
4. **Mandati i Komisionit sipas Rregullores së re të Kuvendit,**
5. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime. Në fillim kryetari priti vizitorët e Kuvendit-studentët nga Gjilani të cilëve ju sqaroi kompetencat e Komisionit.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 31.10.2011

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 31.10.2011.

3. Takimi i komisionit me Këshillin për trashëgimin kulturore

Kryetari Nait Hasani falënderoi pjesëmarrjen e Këshillit të ftuar dhe fillimisht i njohu me ecurinë e procedurës parlamentare rreth dy projektligjeve për Hoçën e Madhe dhe Prizrenin. Ai tha se me këto dy projekte synohet që trashëgimia ortodokse (trashëgimia katolike është ndarë) të përfshijë edhe atë çka i takon trashëgimisë shqiptare, si dhe është tentua brenda një komune të krijojë edhe një tjetër si zonë e mbrojtur, e jo si zonë kadastrale (Hoça e Madhe). Edhe pse ndoshta komisioni është vonuar të ftojë këtë këshillë për konsultime, ai ftoi anëtarët e këshillit në bashkëpunim të mëtejshëm, ngase poçes vazhdohet në këtë mënyrë, me siguri dikush do të mundohet të sjellë për secilin fshat në Kosovë nga një ligj.

Liburn Aliu në cilësinë e kryesuesit të grupit punues për Hoçën e Madhe, në fillim tha se komisioni me këtë këshillë dëshiron që përveç këtyre dy projektligjeve, të shqyrtojë edhe gatishmërinë për nismat e tilla në të ardhmen sa i përket kujdesit dhe syqeltësisë. Fokusi i tij ishte a është në kundërshtim Ligji për Zonat e veçanta me këto dy projektligje dhe si të veprohet më tutje, ngase sipas tij nuk është në rregull që këto dy zona të nënshtrohen KZM-së (Këshillit për zbatimin e monitorimit). Ai kishte vërejtje edhe në aspektin e përfshirjes vetëm të serbëve me këto projekte, kur dihet mirë se deri në shekullin 19 në Hoçën e Madhe kanë jetuar edhe shqiptarë. Ai kërkoi mendim profesional në aspektin e trashëgimisë kulturore.

Nijazi Idrizi tha se komisioni është informuar se këto dy projekte janë derivat i Ligjit për zonat e veçanta dhe Planifikimit Hapësinor, mirëpo në ndërkohë janë shfaqur kundërshtime politike, në anën tjetër nuk janë plotësuar edhe kushtet financiare (nuk ka pasur buxhet për këto dy projekte), ndaj komisioni ka vendosur për moskalimin e tyre, megjithatë ai konsideroi se duhet disa të tejkalohen këto pengesa përmes amendamentimit të tyre, ku prapë ka pasur vërejtje ngase është thënë që nuk mund të preken por duhet të shkojnë si të tilla, kështu që komisioni ka ngecur këtu.

Salih Morina falënderoi këshillin dhe vlerësoi peshën e tij që ka lidhur me këto dy projekte. Ai tha se qysh në fillim Qeveria është dashur të drejtoi këto dy projekte ministrisë së kulturës si dhe të harmonizohen me ligjet tjera të Pakos së Ahtisarit, Ligjit për Trashëgimin Kulturore etj. Pyetja e tij konkrete ishte çka mund të bëjë ky komision dhe çka mund të ndryshoi duke pas parasysh se janë të harmonizuara këto dy projekte me Ligjin për trashëgimin kulturore.

Etem Arifi shkurtimisht përsëriti të dhënat e diskutuara dhe ftoi Këshillin në bashkëpunim ngase vërejtjet janë dërguar edhe te ky këshill më herët.

Afërdita Berisha u fokusua në pakënaqësinë e qytetarëve të cilat duhet patjetër të mirën parasysh, ngase Kushtetuta me nenin 8 definon se jemi shtet laik, ndërsa në anën tjetër sugjerohet involvimi i komuniteteve fetare në pushtetin politik.

Daut Haradinaj në tërësi përkrahu Liburn Aliun dhe shtoi se ky komision nuk ka më tepër të dhëna sesa aq që tha ai, ndaj ftoi këshillin për sqarime detale. Nuk është në rregull, vazhdoi, të kemi një ligj për një fshat ose p.sh. Patriarkana të udhëheq me Hoçën e Madhe, nesër do të kemi diçka tjetër, kështu që do të shkatërrohet shteti.

Rasim Demiri tha se mbetet pranë kundërshtimeve të dhëna deri tani për këto dy projekte dhe apeloj të mirën parasysh edhe vërejtjet nga bashkësitë tjera fetare.

Nait Hasani para se të jap fjalën anëtarëve të këshillit, formuloi pyetjet për Këshillin: pse kanë heshtur gjatë hartimit të dy projekteve, sa kanë qenë unik në punë etj dhe njoftoi për Rekomandimin e Komisionit për Drejtat e Njeriut, i cili ka vlerësuar se peticioni plotëson kushtet e duhura duke sugjeruar që ky komision është kompetent për shqyrtim.

Zymer Neziri në cilësinë e kryesuesit të këshillit tha se puna vazhdon në këtë këshillë dhe nuk kundërshtoi përgjegjësinë e tij por edhe të gjithë pjesëmarrësve tjerë, ngase bashkërisht duhet të arrihet tek qëllimet e përbashkëta. Ai tha se Këshilli ka reagua me kohë gjithandë në Kosovë, mirëpo problemin kryesor të cilin e ka thënë ai ka hasur në vesh të shurdhër, e ajo është se: “nuk është dashur të niset kësaj, ngase tani po shohim se e tëra duhet prapë të përsëritet në vend se të punojmë diç tjetër”, me kohë ka qenë dashur të mos emërtohet **trashëgimia ortodokse serbe**, ngase diç të tillë askund në botë nuk ka (trashëgimi njënacionale) e cila

trashëgimi shkelë 12 shekujt e shqiptarëve. Ai sqaroi edhe detalet tjera historike dhe shtoi se trashëgimi serbe në Kosovë kemi vetëm 8 shekuj, ndaj si munden ata të janë trashëgimtar të popullit shqiptarë. Popullata që nuk i takon asnjë feje janë të këtij vendi, dmth na duhen 1500 ligje (aq fshatra sa janë në Kosovë). Ai shtoi se këshilli nuk ka funksionuar kur është hartuar Ligji për trashëgimin kulturore (i cili ligj poashtu nuk ka qenë e miratuar në kohën e Pakos së Ahtisarit). Brenga e tij më e madhe ishte se askush nuk pyet dhe nuk brengoset për trashëgiminë tonë shpirtërore.

Gjejlane Hoxha eksperte e licencuar nga UNESCO, tha se këto dy projektligje dalin nga Pakoja e Ahtisarit por në fakt nuk duhet të jetë ashtu ngase në Pako kërkohen **ligjet për zonat rrethuese** e jo për zonat e veçanta të cilat i nënshtrohen planifikimit hapësinor. Dmth pasoja kryesore negative është se këto dy projektligje dalin nga Ligji për Zonat e veçanta i cili është në kundërshtim me Pakon e Ahtisarit i cili në fakt kërkon diçka tjetër. Në anën tjetër këto dy projektligje janë në kundërshtim me Ligjin për trashëgimin kulturore dhe me të gjitha praktikatat ndërkombëtare, për çka domosdo duhet të nënshtrohen ekspertizës ndërkombëtare ku ka ekspert vetëm ndërkombëtarë (Zonë e veçantë është një zonë që ka planifikim territorial, definoi ajo). Këto dy projektligje do të sjellin probleme dhe janë diskriminuese me pasojat të thella, por këshilli është injoruar duke mos e ftuar në asnjë proces të hartimit, sidomos nga ICO. Më tutje ajo shtoi se këto dy projektligje nëse miratohen, do të jenë pengesë për shpalljen e zonave arkeologjike ngase nuk mund të shpallet një zonë me një hartë dhe fllomaster, por ka shumë procedura, në Kosovë nuk janë vetëm dy qendra historike, përfundoi.

Nait Hasani duke u konsultuar me Ligjin për Trashëgimi Kulturore tha se ICO ka bazuar kërkesën tek neni 8.2 për Prizrenin dhe 9.2 për Hoçën konform nenit 6, ndaj ky komision në këtë drejtim duhet të kundërshtoi ligjin **sa ka bazë ligjore të qëndrojnë këto dy paragraf të këtij ligji.**

Liburn Aliu tha se mbi këto dy pika të neneve qëndron Pakoja e Ahtisarit (dmth Pakoja së pari duhet të kundërshtohet), i cili pako përmban 46 ligje tjera (**Nijazi Idrizi**).

Gjejlane Hoxha potencoi që dy termet, protect zone (zonë e mbrojtur) dhe special protection zone (zonë e veçantë e mbrojtur) duhet të dallohen.

Nait Hasani gjithashtu tha se 98% e deputetëve atëherë kanë kundërshtuar pakon, por pastaj kanë votuar atë, ndaj përfundimisht kërkoi nga këshilli që të sqarojnë me shkrim pse është Ligji për Trashëgimin kulturore në kundërshtim me Pakon e Ahtisarit, për të pasur komisioni argumente në procedurën e mëtejme parlamentare, falënderoi mysafirët.

4. Mandati i Komisionit sipas Rregullores së re të Kuvendit

Komisioni u pajtua për mandatin e komisionit i cili do të definohet në rregulloren e re të Kuvendit, si vijon :

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor është komision funksional.

Komisioni, në kuadër të fushëveprimit dhe të përgjegjësiave, i shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me bujqësinë, pylltarinë, mjedisin dhe planifikimin hapësinor.

Fushëveprimi i këtij Komisioni, përfshin:

- Shqyrtimin, mbikëqyrjen e zbatimit dhe hartimin e rekomandimeve për Kuvendin për politikat dhe strategjitë kombëtare të bujqësisë, pylltarisë, mjedisit dhe planifikimin hapësinor;
- Shqyrtimin, mbikëqyrjen e zbatimit dhe hartimin e rekomandimeve për Kuvendin për programin vjetor të Qeverisë dhe raportet mbi gjendjen në bujqësi, pylltari, mjedis dhe planifikimin hapësinor;

- Shqyrtimin e projektligjeve dhe akteve tjera si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre në kuadër të fushëveprimit të tij;
- Shqyrtimin e projektbuxhetit dhe rishikimin e buxhetit për Ministrinë dhe institucionet e pavarura në kuadër të fushëveprimit të tij dhe i rekomandon Komisionit për Buxhet dhe Financa shqyrtimin dhe miratimin e tyre në Kuvend duke i përfshirë edhe amendamentet;
- Shqyrtimin dhe hartimin e rekomandimeve për Kuvendin për raportet vjetore të punës së Ministrive në kuadër të fushëveprimit të tij;
- Shqyrtimin dhe hartimin e rekomandimeve për Kuvendin për raportet vjetore të Institucioneve të Pavarura në kuadër të fushëveprimit të tij;
- Bashkëpunimin dhe përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile në punët e Komisionit;
- Bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave me shtetet e rajonit dhe të Bashkimit Evropian në fushat e bujqësisë, pylltarisë, mjedisit dhe planifikimin hapësinor; dhe
- Shqyrtimin e çështjeve tjera të përcaktuara me këtë Rregullore dhe çështjet të cilat, me vendim të veçantë të Kuvendit, i barten këtij Komisioni.

Për realizimin e fushëveprimit, Komisioni bashkëpunon me Ministrinë, Institucionet e Pavarura dhe autoritetet komunale të fushës së bujqësisë, pylltarisë, mjedisit dhe planifikimin hapësinor dhe të gjitha ministrinë tjera, nga të cilat mund të kërkoj të dhëna konkrete, duke përfshirë këtu edhe raportet e drejtpërdrejta të ministrave ose të personave tjerë përgjegjës, kur kjo kërkohet nga Komisioni.

Mbledhja përfundoi në orën 12,45.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani